



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 763 Prot.

Roskovec, më 30.01 2025

V E N D I M

Nr. 6, datë 29.01 /2025

“ P Ë R

MIRATIMIN E NDIHMËS PËR DJEGIEN E BANESËS SË Z.SHPËTIM KUQO, NË FSHATIN VIDHISHT, NJËSIA ADMINISTRATIVE KUMAN, BASHKIA ROSKOVEC PËR VITIN 2025”

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 Ligjit Nr.139/2015 datë 19.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore“, të ndryshuar ,Ligjit Nr.45/2019, datë 18.07.2019 , “Për mbrojtjen civile ,”VKM Nr.329, datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, si dhe shkresës Nr.174 prot. datë 13.01.2025 të Sektorit të Zbatshmerisë së Investimeve të Bashkisë Roskovec, Kërkesës Nr.193 prot. datë 14. 01 .2025 për dëmshpërblim, Këshilli i Bashkisë,

-VENDOSI :

- I. Miratimin e vlerës financiare të dëmeve të shkaktuara nga djegia në banesën e Z.Shpëtim Kuqo, ndodhur në fshatin Vidhisht, Njësia Administrative Kuman, Bashkia Roskovec sipas preventivit të hartuar përkatësisht në masën 215,842 lekë.
- II. Shpërblimi financiar do të përballohet nga fondi i Emergjencave Civile të Bashkisë Roskovec.
- III. Ngarkohet Administrata e Bashkisë për zbatimin e këtij vendimi.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR
Afrim Plaka

